



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-115
Datë: 30.08.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.08.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Association for Finance and Accounting Services- AFAS në Prishtinë me adresë Bulevardi "Nëna Terezë" 3 OA Hyrja 1 numër 1, për periudhën 16.08.2017 deri 16.08.2020 me kualifikimin:
 - 1.1. **Nëpunës i kontabilitetit, Niveli III sipas KKK me 10 kredi të AAP.**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
 - 2.1. Plotësimi i bazës Agjenda (plani) i pjesëmarrjes së stafit edukativ në përsosjen e tyre (konferencat, seminarët).
 - 2.2. Personave me nevoja të veçanta t'iu mundësohet një qasje e arsyeshme në certifikim.
 - 2.3. Rekomandohet që për secilin kandidat të ekzistoj dosje fizike në të cilën do të gjendej dokumentacioni mbi të arriturat arsimore dhe testet e provimeve të dhëna.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 30.08.2017, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për

Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- AFAS;
- AKK.



Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së